

Lotaria Kombëtare sh.p.k.

Pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Me raportin e audituesve të pavarur bashkëlidhur)

Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime për pasqyrat financiare	5 – 24



KPMG Albania Shpk
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Pronarit të
Lotaria Kombëtare sh.p.k

Tiranë, 29 korrik 2016

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Lotaria Kombëtare sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi ynë, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015, rezultatit e saj financiar dhe flukset e saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Heris Jani
Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk
"Deshmoret e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Pasqyra e pozicionit financiar

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Aktive			
Aktive afatgjata të trupëzuara	6	268,814,272	321,646,278
Aktive afatgjata të patrupëzuara	7	378,533,116	434,870,387
Parapagime	8	-	1,554,000
Totali i aktiveve afatgjata		647,347,388	758,070,665
Tatim fitimi i parapaguar		40,000	40,000
Inventarët	9	74,160,512	62,103,731
Kërkesa të arkëtueshme	10	31,343,906	19,422,481
Aktive të tjera	11	6,976,490	11,818,665
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	25,899,013	28,930,460
Totali i aktiveve afatshkurtra		138,419,921	122,315,337
Totali i aktiveve		785,767,309	880,386,002
Kapitali			
Kapitali aksionar	13	1,201,950,000	1,201,950,000
Humbjet e mbartura		(1,396,377,883)	(1,152,911,333)
Totali i kapitalit		(194,427,883)	49,038,667
Detyrimet			
Kredi dhe hua afatgjata	14	869,246,919	591,170,028
Detyrime tatimore të shtyra	26	7,622,740	1,183,621
Totali i detyrimeve afatgjata		876,869,659	592,353,649
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata	14	7,800	71,968,967
Të pagueshme ndaj furnitorëve	15	11,205,573	47,532,847
Detyrime të tjera	16	92,112,160	119,491,872
Detyrime afatshkurtra		103,325,533	238,993,686
Totali i detyrimeve		980,195,192	831,347,335
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		785,767,309	880,386,002

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri ne 24.

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga lotaritë	17	320,409,605	585,844,750
Të ardhura të tjera		49,582,400	380,100
Totali i te ardhurave		369,992,005	586,224,850
Shpenzime marketingu	18	(37,318,764)	(210,873,764)
Shpenzime për çmimet e lotarisë	19	(182,042,101)	(309,549,342)
Shpenzime personeli	20	(93,607,967)	(132,099,239)
Tarifat dhe taksat mbi lojërat e fatit	21	(40,959,953)	(75,956,808)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7	(112,551,419)	(104,623,255)
Komisione për agjentët	22	(33,885,259)	(50,903,118)
Shpenzime për materialet	23	(11,878,872)	(21,200,561)
Shpenzime të tjera operative	24	(65,067,220)	(143,510,358)
Rezultati nga veprimtaria operative		(207,319,550)	(462,491,595)
Shpenzime financiare	25	(46,760,806)	(30,846,610)
Të ardhura financiare	25	17,052,926	470,565
Shpenzime financiare, neto		(29,707,880)	(30,376,045)
Humbja para tatim-fitimit		(237,027,430)	(492,867,640)
Shpenzim nga tatimi i shtyrë	26	(6,439,120)	(3,876,359)
Humbja për periudhën		(243,466,550)	(496,743,999)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën		(243,466,550)	(496,743,999)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri në 24.

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksionar	Humbjet e mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2014	1,201,950,000	(656,167,334)	545,782,666
Totali humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën			
Humbja për periudhën	-	(496,743,999)	(496,743,999)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të periudhës	-	(496,743,999)	(496,743,999)
Transaksionet me pronarët e Shoqërisë, të njohura direkt në kapital	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	1,201,950,000	(1,152,911,333)	49,038,667
Totali humbjes gjithëpërfshirëse për periudhën			
Humbja për periudhën	-	(243,466,550)	(243,466,550)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të periudhës	-	(243,466,550)	(243,466,550)
Transaksionet me pronarët e Shoqërisë, të njohura direkt në kapital	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,201,950,000	(1,396,377,883)	(194,427,883)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, në faqet 5 deri në 24.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Lotaria Kombëtare sh.p.k më 29 korrik 2016

Peter Simoner

Drejtor ekzekutiv

Nevila Muca

Drejtoreshë e Financës



Lotaria Kombëtare sh.p.k
Pasqyra e flukseve monetare

(Shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukse monetare nga aktiviteti operativ			
Humbja para tatim fitimit		(237,027,430)	(492,867,640)
<i>Rregullime:</i>			
Zhvlerësimi	6	56,020,336	48,251,517
Amortizimi	7	56,531,083	56,371,738
Vlera kontabël neto e aktiveve të shitura	24	657,706	282,243
Shpenzime financiare	25	46,760,806	30,191,326
Të ardhura nga interesat dhe të tjera financiare	25	(13,774)	(470,565)
		(77,071,273)	(358,241,381)
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</i>			
Rritja në inventarë	9	(12,056,781)	(20,468,970)
(Rritja)/pakësimi në të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	10	(11,921,425)	24,508,308
Pakësimi/(rritja) në aktive të tjera	11	4,842,175	(4,932,375)
Pakësimi në furnitorë	15	(36,327,274)	(16,477,866)
(Pakësimi)/rritja në detyrimet e tjera	16	(27,379,712)	33,314,896
		(159,914,290)	(342,297,388)
Interesa dhe të ardhura të tjera financiare të marra	25	13,774	470,565
Komisione bankare dhe të tjera financiare	25	(462,655)	(567,195)
		(160,363,171)	(342,394,018)
Flukse monetare neto nga aktiviteti operativ			
Flukse monetare nga aktiviteti investues			
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	6	(4,035,374)	(43,355,041)
Të hyra nga shitja e aktiveve të qëndrueshme		189,338	330,649
Ndryshim në parapagime për aktive		1,554,000	(1,554,000)
Blerje e aktiveve të patrupëzuara	7	(193,812)	(1,776,807)
		(2,485,848)	(46,355,199)
Flukse monetare neto nga aktiviteti investues			
Flukse monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues			
Shuma të marra nga huatë e reja	14	206,115,724	420,288,225
Shuma të paguara të huave		-	(37,549,230)
Interesi i paguar	25	(46,298,152)	(29,515,450)
		159,817,572	353,223,545
Flukse monetare neto nga aktiviteti financues			
Pakësimi neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to			
		(3,031,447)	(35,525,672)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës			
	12	28,930,460	64,456,132
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës			
	12	25,899,013	28,930,460

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri në 24.

1. Informacion i përgjithshëm

Lotaria Kombëtare sh.p.k (“Shoqëria”), e quajtur me parë OLG Project sh.p.k u krijua në Shqipëri si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 19 shtator 2012, me adresë të regjistruar Rruga Dritan Hoxha No. 39-1, Laprakë, Tiranë, dhe e regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit me numër unik identifikimi L22119005R, është një filial në pronësi të plotë të Österreichische Lotterien Holding Gesellschaft (“Shoqëria mëmë” - direkte), e cila është një shoqëri ‘holding’ me vendndodhje në Vienë, Austri, dhe adresë biznesi në Rennweg 44, 1038 Vienë, Austri, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës Tregtare të Vienës nën FN 383662, e cila është një filial nën pronësinë e plotë të Österreichische Lotterien Gesellschaft m.b.H., e cila fitoi tenderin për administrimin ekskluziv të Lotarisë Kombëtare në Shqipëri, sipas licencës së dhënë nga Qeveria e Shqipërisë më 19 dhjetor 2012, lëshuar nga Ministria e Financës për një periudhë prej 10 vitesh.

Aktiviteti i regjistruar i Shoqërisë është në veprimtarinë e industrisë së lojërave të fatit. Shoqëria ka paguar një tarifë për licencën prej 500,000,000 Lek ndaj Ministrisë së Financave të Shqipërisë me 15 tetor 2012. Shoqëria administrohet nga Z. Peter Simoner, administratori i vetëm i Shoqërisë. Zyrat qendrore të Lotaria Kombëtare ndodhen në Tiranë, rruga “Dritan Hoxha”, 39-1.

Marrëveshja e licencës u ratifikua nga Parlamenti dhe ka hyrë në fuqi më 3 prill 2014, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 95/2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për lotarinë kombëtare, ndërmjet Ministrisë së Financës, si autoritet i autorizuar dhe ‘Oesterreichische Lotterien GmbH’, nëpërmjet shoqërisë ‘OLG Project’ sh.p.k’.

Aktiviteti i Shoqërisë filloi në prill të 2013 me prezantimin e produktit të parë “Loto 6 nga 39”. Shoqëria prezantoi tre produkte të tjerë si biletat gërvishëse “FitoFito” dhe Keno respektivisht në 2013, 2014 dhe 2015.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 është 1,201,950,000 Lek (31 dhjetor 2014: 1,201,950,000 Lek).

Shoqëria ka 47 punonjës më 31 dhjetor 2015 (2014: 63), duke përfshirë 1 punonjës të huaj.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare bashkangjitur janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të cilat janë baza për raportimin financiar ligjor të Shoqërisë.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Vlerësimi i drejtimit lidhur me aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar mbi parimin e vijmësisë

Shoqëria ka akumuluar humbje prej 1,396,377,883 Lek më 31 dhjetor 2015 (2014: 1,152,911,333 Lek). Një pjesë e konsiderueshme e kësaj humbje i atribuohet fazës fillestare, që përfshin investime dhe shpenzime mjaft të larta në marketing. Për të përmbushur nevojat për kapital dhe likuiditet dhe për të vazhduar aktivitetin, Shoqëria ka marrë hua nga banka Raiffeisen Albania (shënimi 14).

Si përgjigje ndaj zhvillimeve të tregut gjatë vitit 2015 dhe performancës së produkteve të hedhura në treg gjatë dy viteve të para të aktivitetit, Shoqëria ka rishikuar strategjinë e biznesit dhe strukturën operacionale, duke e përshtatur atë më shumë me nevojat e tregut lokal.

Shoqëria nuk ka për qëllim likuidimin apo mbylljen e aktivitetit në një të ardhme të afërt dhe prindi do vazhdojë ta mbështesë aktivitetin në Shqipëri financiarisht. Drejtimi mendon se Shoqëria do jetë në gjendje të gjenerojë të ardhura brenda vitit 2017 dhe aftësia e saj për të vazhduar mbi parimin e vijmësisë nuk do të rrezikohet. Për këtë arsye, Shoqëria i ka përgatitur këto pasqyra financiare mbi parimin e vijmësisë (shiko shënimin 29).

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(d) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet mbi të cilat vlerësimet ndërtohen rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të ndikuar. Në mënyrë të veçantë, informacioni rreth fushave të rëndësishme të vlerësimeve të pasigurta dhe të gjykimeve kritike në zbatimin e IFRS-ve, të cilat kanë ndikimin më të madh në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 4.

3. Politikat kontabël të rëndësishme

Politikat kontabël më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit.

Në rastet kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja nga shitja apo nxjerrja jashtë përdorimit e një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e kontabël dhe njihen në vlerë neto në të ardhura të tjera/humbje të tjera operative dhe përfshihen në fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme ndaj aktiveve afatgjata materiale njihen si në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi pasqyrohet në fitime ose humbje bazuar në metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve afatgjata materiale nga data kur ato janë gati për përdorim.

Jetëgjatësitë e parashikuara janë si më poshtë:

Pajisje TI	3-8 vite
Pajisje te lojërave të fatit	10 vite
Makina	5 vite
Mobilje dhe pajisje zyre	5 vite
Të tjera	5 vite

Aktivitetet e marra me qira dhe përmirësimi i ambienteve të marra me qira amortizohen mbi jetëgjatësinë më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme, përveç rasteve kur është e sigurt se Shoqëria do të marre në pronësi aktivitetin në fund të afatit të qirasë. Në këto raste amortizimi llogaritet mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktivitetit.

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(b) Aktivët afatgjata jo-materiale

Aktivët afatgjata jo-materiale të blera nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi (nëse ka). Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve afatgjata jo materiale nga data në të cilën ato janë të disponueshme për përdorim. Jetëgjatësia e parashikuar e përdorimit është si më poshtë:

Programe Kompjuterike	4 vite
Licensa	10 vite

(c) Inventarët

Inventarët janë matur me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet bazuar në parimin ("FIFO") për biletat gërvishtëse, ndërsa për pjesën e mbetur të inventarit, përdoret parimi i koston mesatare të ponderuar dhe përfshin koston e blerjes, koston e shndërrimit dhe gjithë koston e tjera për të sjellë inventarët në vendndodhjen dhe në kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë, minus koston e vlerësuar të përfundimit të shitjes.

(d) Aktivët e marra me qira

Qiratë, për të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë i mbeten qiradhënësit, klasifikohen si qira operative. Pagesat e kryera mbi bazën e qirasë operative (neto nga çdo zbritje e marrë nga qiradhënësi) njihen në fitim ose humbje mbi baza lineare përgjatë periudhës së qirasë.

(e) Instrumentet financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative.

(i) Aktive financiare jo-derivative

Shoqëria fillimisht njihet llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën në të cilën janë krijuar. Të gjitha aktivët e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron aktivët financiare nëse të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivët financiar mbarojnë, ose nëse ajo i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivët financiar një pale tjetër, duke transferuar në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivët financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Aktivët dhe detyrimet financiare netohen së bashku dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për ti kompensuar shumat dhe ka për qëllim ose shlyerjen me vlerë neto, ose të realizojë shitjen e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

(ii) Mjete monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë mjetet monetare në arkë, depozita afatshkurtra bankare, të tjera investime afatshkurtër me likuiditet të lartë me maturitet fillestar deri në tre muaj ose më pak, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, dhe Shoqëria i përdor për menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

(iii) Kërkesa të arkëtueshme

Kërkesat e arkëtueshme janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive. Këto aktive njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus kosto direkte të transaksionit. Në vazhdim, llogaritë e arkëtueshme e të tjera të arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi (shih shënimin 3)(f)(i)).

(iv) Detyrime financiare jo-derivative

Shoqëria i njihet fillimisht detyrimet financiare, në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(e) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iv) Detyrime financiare jo-derivative (vazhdim)

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë, kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe synon ose të shlyejë mbi bazën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Shoqëria ka këto detyrime financiare jo-derivative: huatë, detyrimet të tjera dhe te pagueshme ndaj furnitorëve.

Detyrime të tilla financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus çdo kosto të drejtpërdrejt të transaksionit. Pas njohjes fillestare, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare është diskutuar në politikën kontabël 3(n).

(v) Kapitali aksionar

Kapitali i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

(f) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar jo i mbajtur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese, për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë ndikim negativ në flukset e ardhshme të parashikuara të atij aktivi dhe kjo mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë pamundësi apo vështirësi të një klienti për të realizuar pagesën, ristrukturim të një detyrimi ndaj Shoqërisë me kushte që Shoqëria nuk do të t'i merrte në konsideratë në rast të tjera, ose tregues që një klient do të shpallë falimentim.

Humbja nga zhvlerësimi i aktiveve financiare me kosto të amortizuar, matet si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme të skontuar me normën fillestare efektive. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në baza individuale. Aktivet financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në grupe të cilat kanë karakteristika të njëjta të rrezikut të kreditimit.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim ose humbje. Humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerrtet), nëse kthimi ka lidhje objektive me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me koston e amortizimit, kthimi njihet në fitim ose humbje.

(ii) Aktive jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimorë të shtyrë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston një tregues i tillë, atëherë vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (NJGJMM) tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e aktivitetit ose NJGJMM është më e madhja midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të aktivitetit ose NJGJMM. Për testimin e zhvlerësimit, aktivet grupohen së bashku në grupet më të vogla të aktiveve që gjeneron flukse monetare hyrëse nga përdorimi i vazhdueshëm, të cilat janë të pavarura nga flukset monetare hyrëse të aktiveve të tjera ose NJGJMM.

Humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje. Humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerrtet), deri në nivelin kur vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që duhet të kishte patur aktiviteti duke zbritur amortizimin, nëse humbja nga zhvlerësimi nuk do ishte njohur ndonjëherë.

3. Politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

(g) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen fillimisht me vlerën e drejtë të shumës së arkëtueshme neto nga skontot dhe zbritjet.

Të ardhurat nga biletat e shitura tek konsumatorët për lojërat e fatit, për të cilat rezultati përcaktohet bazuar në një short njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në momentin që shorti hidhet. Kur lojtaret luajnë një shumë në avancë, kjo e ardhur shtyhet dhe njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse atëherë kur shorti përkatës realizohet.

Të ardhurat nga biletat gërvishtëse njihen kur janë bërë të disponueshme për shitje tek publiku, moment në të cilin bëhet aktivizimi i biletave në sistem.

Të ardhurat nga interesi njihen mbi baza të përlllogaritura kur përfitohen dhe raportohen në periudhën financiare me të cilën lidhen.

(h) Çmimet e lotarisë

Loja me bazë shorti “Loto 6 nga 39” është organizuar në bazë të një mekanizmi çmimesh sipas së cilit një përqindje e paracaktuar nga biletat e shitura alokohet për fondin e çmimeve. Në masën që çmimet e fituara prej shorteve në “Loto 6 nga 39”, ndryshojnë nga përqindja e paracaktuar e çmimeve, çmimet përkatëse mbarten në fondin për çmimet e ardhshme. Detyrimi për çmimet njihet në momentin e realizimit të shortit në përputhje me përqindjet e paracaktuara.

Produkte të tjera “Fito Fito” të bazuar në shorte operojnë me shuma fikse koeficientesh të ndara për çdo kategori fituese, me fondin total të çmimeve që varion në piramidat fituese dhe njihet në çdo short përkatës.

Çmimet për biletat gërvishtëse njihen si përqindje ndaj shitjeve në përputhje me piramidën teorike të pagesave për çmimet.

Çmimet e fituara por të pa tërhequra në lojën kombëtare” Loto 6 nga 39” për më shumë se 90 ditë, janë kthyer në lojë nëpërmjet “jackpot-eve” të garantuara dhe çmimeve promovuese në përputhje me rregullat e lojërave të fatit të aprovuara nga autoritet rregullatorë.

(i) Komisionet dhe bonuset

Komisionet dhe bonuset e njohura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfaqësojnë komisione të cilat shkaktohen si pasojë: (i) e normave fikse mbi shitjet e bëra prej rishitësve dhe; (ii) shpërblime dhe bonuse të tjera të lidhura me shitjet. Kur një komision i paguhet një agjenti për shitjen e biletave të cilat i përkasin shorteve të ardhshëm, kjo shumë regjistrohet si shpenzim i parapaguar derisa e ardhura përkatëse të njihet.

(j) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Zbritjet e marre për qiranë njihen si pjesë përbërëse e pagesës totale të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së saj.

(k) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

(l) Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitime në trajta pensioni për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

(ii) Pagesat për lejet vjetore

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës së mbyllur.

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. Politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

(m) Provizionet

Një provizion njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose konstruktiv, që mund të matet në mënyre të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohej një fluks dalës të përfitimesh ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi i skontos njihet si kosto financiare.

(n) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet e investuara në banka dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Te ardhurat nga interesat njihen kur përfitohen, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi, komisione bankare dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit prezantohen neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi të faktit nëse lëvizjet në kursin e këmbimit rezultojnë në një pozicion neto fitimi apo humbje.

(o) Tatimi mbi lojërat e fatit

Bazuar në marrëveshjen e licencës me Qeverinë e Shqipërisë, Shoqëria është e detyruar të paguajë detyrime tatimore bazuar mbi totalin e qarkullimit bruto si me poshtë:

- Tatim mbi lojërat e fatit prej 10%;
- Tarifë kontributi për çështjet e mira prej 2.2%;
- Tarifë administrimi për njësinë e mbikëqyrjes së lojërave të fatit në masën 0.5%, por jo më pak se 2,000,000 Lek në vit (ponderuar në rast të një viti jo të plotë).

(p) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit fitimit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin apo humbjen e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose që do të miratohen në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Drejtimi vlerëson periodikisht pozicionin e marrë në deklaratat e raportuara tatimore presa i përket situatave në të cilat rregullorja e aplikueshme tatimore përbën subjekt interpretimi. Aty ku është e përshtatshme, drejtimi përcakton provizionim bazuar në shumën e pritshme për t'u paguar autoriteteve tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi ose që pritet të hyjë në fuqi deri në datën e raportimit.

Aktivet dhe pasivet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet dhe aktivet aktuale, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme në masën që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Shoqëria njeh një aktiv tatimor të shtyrë mbi humbjet tatimore të mbartura në masën që është e mundur që këto humbje mund të përdoren kundrejt një fitimi të tatueshëm të ardhshëm.

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(q) Transaksionet dhe balancat në valutë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në fuqi në datat e transaksioneve. Aktivët dhe detyrimet të shprehura në valutë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit, në atë datë.

Fitimi ose humbja në zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në normën e këmbimit të fundit të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në valutë të huaj që janë matur me vlerë të drejtë konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten në termat e kostos historike përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në 'Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto'.

(r) Standarde dhe interpretime të reja që nuk janë ende efektive

Disa standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime nuk janë ende në fuqi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, dhe nuk janë zbatuar para kohe në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Standardet që mund të jenë relevante për Shoqërinë janë paraqitur më poshtë. Shoqëria nuk ka në plan të zbatojë këto standarde dhe ndryshime para kohe.

SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët

SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët (në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017, me zbatim më të hershëm të lejuar) zëvendëson standardet dhe udhëzimet ekzistuese mbi njohjen e të ardhurave, duke përfshirë SNK 18 Të Ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe KIRFN 13 Programet për Besnikërinë e Klientëve. Standardi i ri është efektiv për periudha raportuese me ose pas 1 janarit 2018, me zbatim të hershëm të lejuar. Shoqëria është duke vlerësuar efektin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare të zbatimit të SNRF 15. Standardet e reja apo të ndryshuara më poshtë nuk pritet të kenë efekt të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë:

Efektive për periudhat raportuese vjetore prej ose pas 1 janarit 2016:

- SNRF 14: Llogaritë e Shtyra për arsye Rregullatore
- Ndryshimet në SNRF 11: Kontabiliteti i Blerjeve të Interesave në Operacione të Përbashkëta
- Ndryshimet në SNRF 10, 12 dhe SNK 28: Njësitë Investuese – Zbatimi i Përrjashtimit për Konsolidimin
- Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38: Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit
- Ndryshimet në SNK 1: Iniciativa për dhënien e informacioneve shpjeguese
- Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 40: Bimët Prodhuese
- Ndryshime në SNK 19: Planet e Përfitimeve të Përcaktuara: Kontributet e Punonjësve
- Ndryshime në SNK 27: Metoda e Kapitalit neto në Pasqyrat Financiare Individuale

Efektive për periudhat raportuese vjetore prej ose më pas 1 janarit 2017:

- Ndryshimet në SNK 7: Iniciativa për dhënien e informacioneve shpjeguese
- Ndryshimet në SNK 12: Njohja e Aktiveve Tatimore të Shtyra për Humbjet e Perealizuara

Efektive për periudhat raportuese vjetore prej ose më pas 1 janar 2018:

- SNRF 9: Instrumentet financiare

Efektive për periudhat raportuese vjetore prej ose më pas 1 janarit 2019:

- SNRF 16: Qiratë

Data kur bëhet efektive nuk është përcaktuar akoma, por zbatimi i mëhershëm lejohet për:

- Ndryshime të SNRF 10 dhe SNK 28: Shitjet ose Kontributet në Aktive ndërmjet një Investitori dhe Pjesëmarrjeve të tij apo Sipërmarrjeve të tij të Përbashkëta.

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme

Një numër i politikave dhe paraqitjeve kontabël të Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës se drejte si për aktivet dhe detyrimet financiare dhe ato jo financiarë. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe/ose paraqitjes, bazuar në metodat vijuese. Kur është e zbatueshme, informacion i mëtejshëm për supozimet e bëra, në përcaktimin e vlerave të drejta pasqyrohen në shënimet specifike për atë aktiv ose detyrim. Për më tepër, në shënimin 26 përshkruhen gjykimet e përdorura në njohjen e aktiveve tatimore të shtyra.

(a) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Pavarësisht humbjeve të ndodhura gjatë viteve të para të veprimtarisë të Shoqërisë deri tani, ajo pret të rezultojë fitimprurëse dhe të gjenerojë flukse monetare pozitive në të ardhmen.

Pas ndodhjes së ngjarjeve në periudhën pasuese të sqaruara në shënimin 29, Shoqëria ka përdorur çmimin e transaksionit për të përcaktuar vlerën e drejtë të aktiveve. Si rezultat, drejtimi konkludoi se aktivet nuk janë zhvlerësuar.

Projektimet e flukseve monetare të ardhshme varen nga rishikimi dhe përfundimi i suksesshëm i produkteve të Shoqërisë dhe përshtatja e mëtejshme e tyre ndaj tregut lokal. Megjithatë në vitin aktual humbjet janë ndikuar edhe nga pritjet fillestare shumë optimiste, Shoqëria po merr masa për të ulur kostot dhe të rezultojë fitimprurëse në 2017. Ajo është duke analizuar nevojat për të rishikuar planin e marketingut, ndërsa buxheti tashmë është rishikuar. Më tej, Shoqëria është në proces analizimi të nevojave të saj për të përshtatur më tej produktet e saj ndaj tregut Shqiptar. Numri i pikave të shitjes pritet të rritet dhe lloje të reja biletash gërvishëse si edhe produkte të reja do të prezantohen tek konsumatorët në të ardhmen e afërt.

(b) Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Vlera e drejte për llogaritë e arkëtueshme është vlerësuar me vlerën aktuale të flukseve të ardhshme monetare, skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit. Kjo vlerë e drejtë është përcaktuar për qëllime të shënimeve shpjeguese.

(c) Aktivet monetare dhe ekuivalentë

Aktivitet monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet monetare në arkë dhe llogaritë rrjedhëse me bankat vendore. Meqenëse këto teprica janë afatshkurtër, vlera e tyre e drejtë e tregut është konsideruar të jetë e barabartë me vlerën e mbartur.

(d) Detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e tregut, e cila përcaktohet për qëllime paraqitjeje, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve monetare të principalit dhe interesave, të skontuara me normën e interesat të tregut në datën e raportimit. Për huamarrjet, norma e interesit e tregut përcaktohet duke iu referuar marrëveshjeve të ngjashme.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar nga rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i tregut
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i kredisë

Ky shënim përfaqëson informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat e Shoqërisë, politikat dhe procedurat e matjes dhe menaxhimit të rrezikut dhe menaxhimit të kapitalit të Shoqërisë. Shënime të tjera shpjeguese sasiore janë të përfshira përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat Shoqëria përballet, për të vendosur limitet dhe kontrolle, dhe monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve.

Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin çdo punonjës kupton rolin dhe detyrimet përkatëse.

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rrjedhojë e ndryshimeve në çmimet e tregut, në kurset e këmbimit të valutës, në normat e interesit dhe në çmimet e kapitalit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit ekspozohet Shoqëria, në një moment të caktuar kohe ndryshon në varësi të kushteve të tregut, të pritshmërive të çmimeve të ardhshme apo lëvizjeve në normat e tregut, të përbërjes së aktiveve fizike të Shoqërisë dhe marrëveshjeve në të cilat Shoqëria është angazhuar. Drejtimi vendos limite mbi vlerën e rrezikut që mund të jetë i pranueshëm, i cili monitorohet çdo muaj. Gjithsesi, kjo qasje nuk parandalon humbjet përtej këtyre limiteve në rast të lëvizjeve më të mëdha të tregut.

(i) Rreziku i kursit të këmbimit

Pjesa më e madhe e transaksioneve të Shoqërisë kryhet në monedhat Lek dhe Euro. Rreziku i kursit të këmbimit krijohet kur transaksione të ardhshme tregtare ose aktive dhe detyrime të njohura janë të shprehura në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e Shoqërisë. Duke qenë se huatë janë marrë në Euro, dhe aktiviteti kryhet në Lek, ekziston rreziku i mospërputhjes së monedhave të huaja. Meqë monedha raportuese është Leku, drejtimi vlerëson se rreziku i monedhës së huaj mund të përbëjë një problem për Shoqërinë. Drejtimi vendos kufij mbi nivelin e ekspozimit për çdo monedhë dhe në total. Pozicionet monitorohen çdo muaj. Kurset e këmbimit të mëposhtme, janë aplikuar gjatë periudhës:

	Kursi mesatar		Kursi i këmbimit në datën e raportimit	
	2015	2014	2015	2014
Lek / EUR	139.74	139.97	137.28	140.14
Lek / USD	125.96	105.48	125.79	115.23
Lek / CAD	101.48	95.49	90.53	99.55

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 ëshë si më poshtë:

31 dhjetor 2015	Euro	Lek	Totali
	(shuma ekuivalente në Lek)		
Aktivet financiare			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	16,660,113	9,238,900	25,899,013
Kërkesa të arkëtueshme	4,163,948	27,179,958	31,343,906
	20,824,061	36,418,858	57,242,919
Detyrimet financiare			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	6,015,197	5,190,376	11,205,573
Detyrime të tjera	420,000	91,692,160	92,112,160
Hua	869,254,719	-	869,254,719
	875,689,916	96,882,536	972,572,452
Ekspozimi neto	(854,865,855)	(60,463,678)	(915,329,533)

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(a) Rreziku i tregut (vazhdim)**(i) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)*

31 dhjetor 2014	Euro	Lek	Totali
	(shuma ekuivalente në Lek)		
Aktivët financiarë			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	15,105,737	13,824,723	28,930,460
Kërkesa të arkëtueshme	367,838	19,054,643	19,422,481
	15,473,575	32,879,366	48,352,941
Detyrimet financiarë			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	29,224,101	18,308,746	47,532,847
Detyrime të tjera	420,300	119,071,572	119,491,872
Hua	663,138,995	-	663,138,995
	692,783,396	137,380,318	830,163,714
Ekspozimi neto	(677,309,821)	(104,500,952)	(781,810,773)

Në menaxhimin e rrezikut aktual, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Kompanisë. Në afatgjatë, megjithatë, ndryshime të përhershme në kursin e këmbimit të monedhës së huaj mund të kenë një ndikim në fitim. Një vlerësim ose zhvlerësim i Lekut, siç paraqitet më poshtë, mund të ketë ndikimet përkatëse në ulje ose rritje të kapitalit dhe të fitimit ose humbjes me shumat e paraqitura më poshtë. Kjo analizë bazohet në variancat prej 10% të kurseve të këmbimit të monedhave të huaja, që Shoqëria konsideron në mënyrë të arsyeshme të mundshme në fund të periudhës raportuese.

<i>Në Lek</i>	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Rritje	Ulje	Rritje	Ulje
EUR	(76,937,927)	76,937,927	(60,957,884)	60,957,884

(ii) Rreziku i normës së interesit

Rreziku kyresor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar janë rreziqet nga luhatja e flukseve të ardhshme monetare ose vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë për shkak të ndryshimit të normës së interesit të tregut (ndryshimi/hendeku mes vlerës aktuale neto të aktiveve dhe detyrimeve). Rreziku i normës së interesit manaxhohet kryesisht nëpërmjet monitorimit të diferencave të normave të interesit. Menaxhimi i rrezikut të normës të interesit kundrejt kufijve të ndryshimit të normës së interesit plotësohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë ndaj skenarëve të ndryshëm standarde dhe jo standarde të normave të interesit. Skenarë standarde që konsiderohen në baza të rregullta përfshijnë 100 pike baze rënie ose rritje paralele në të gjitha kurbat e normave të kthimit.

Shoqëria ka një hua interes-bartëse me Bankën Raiffeisen Albania (shih shënimin 14). Huatë kanë një normë interesi 5% plus Euribor 1 vjeçar, por jo më pak se 5.3% p.a dhe janë të pagueshme në një këst të vetëm në fund të afatit të maturimit.

Një analizë e ndjeshmërisë së Shoqërisë ndaj rritjes apo rënies së normave të interesit në treg (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit në treg dhe një pozite konstante e pozicionit financiar) jepet si më poshtë:

<i>In Lek</i>	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	100 pb rritje	100 pb rënie	100 pb rritje	100 pb rënie
Efekt i vlerësuar i fitim/(humbjes)	(8,692,547)	8,692,547	(6,631,390)	6,631,390

(iii) Menaxhimi i kapitalit

Bazuar në legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të sigurohet licenca për “Lotari Kombëtare”, kapitali minimal i kërkuar është 1,200,000,000 Lek. Në fund të 31 dhjetorit 2015 dhe 31 dhjetorit 2014, kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 1,201,950,000 Lek.

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(b) Rreziku i likuiditetit*

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve kur ato janë të pagueshme. Shoqëria është e ekspozuar çdo ditë ndaj kërkesës për burimet e saj monetare kryesisht për të shlyer shpenzimet operative që kryhen gjatë aktivitetit të zakonshëm të saj. Qasja e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurohet, sa më shumë të jetë e mundur që do të ketë gjithmonë likuiditetin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e saj në afat, si në kushte normale dhe në ato të rënda, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e imazhit të Shoqërisë.

Shoqëria pret të përmbushë detyrimet përmes flukseve të pritshme të parasë nga aktiviteti.

Tabela e mëposhtme tregon flukset e aktualizuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë duke marrë për bazë maturitetin më të hershëm kontraktual ose flukset e pritshme.

31 dhjetor 2015	Deri ne 3 muaj	Nga 3 muaj deri ne 1 vit	Me shume se 1 vit	Totali
Detyrimet financiare				
Të pagueshme ndaj furnitorëve	11,205,573	-	-	11,205,573
Detyrime të tjera	92,112,160	-	-	92,112,160
Hua	7,800	-	869,246,919	869,254,719
Totali i detyrimeve financiare	103,325,533	-	869,246,919	972,572,452
Pozicioni i likuiditetit neto	(160,568,45)	-	(869,246,919)	(1,029,815,37)
Pozicioni neto kumulativ	(160,568,45)	(160,568,45)	(1,029,815,37)	

31 dhjetor 2014	Deri ne 3 muaj	Nga 3 muaj deri ne 1 vit	Me shume se 1 vit	Totali
Detyrimet financiare				
Të pagueshme ndaj furnitorëve	47,532,847	-	-	47,532,847
Detyrime të tjera	119,491,872	-	-	119,491,872
Hua	6,765	71,962,202	591,170,028	663,138,995
Totali i detyrimeve financiare	167,031,484	71,962,202	591,170,028	830,163,714
Pozicioni i likuiditetit neto	(215,384,425)	(71,962,202)	(591,170,028)	(878,516,655)
Pozicioni neto kumulativ	(215,384,425)	(287,346,627)	(878,516,655)	

(c) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij kontraktual që lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë dhe nga mjetet monetare të mbajtura tek Raiffeisen Bank Albania.

Rreziku potencial i kredisë në marrëdhëniet tregtare ekziston kryesisht me pikat e shitjes nën një marrëveshje bashkëpunimi, zbutet nga procedura specifike të përzgjedhjeje të pikave të shitjes, duke vendosur limite operative mbi vlerat e luajtura në терминаlet e lojërave dhe prej kontrolleve ditore mbi ndryshimin e balancave debitorë, çka në rastet e mos pagesave, mund të rezultojë me bllokimin e terminalit ose revokimin e autorizimit për të vepruar si një pikë shitjeje e Lotarisë Kombëtare kur evidentohen raste të vazhdueshme të mos-pagesave. Kërkesat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 sipas vjetërsisë janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15	%	31 dhjetor 2014	%
Pa vonesë	2,998,990	9.57%	2,888,334	14.87%
Më pak se 1 muaj	21,704,488	69.25%	13,831,659	71.21%
1 deri në 2 muaj	3,948,058	12.60%	1,669,900	8.60%
2 deri në 3 muaj	929,635	2.97%	308,026	1.59%
Mbi 3 muaj	1,762,735	5.62%	724,562	3.73%
Totali	31,343,906	100.00%	19,422,481	100.00%

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

6. Aktive afatgjata materiale

	Paisje te lojrave të fatit	Pajisje kompjuterike	Mjete transporti	Përmirësimi i objekteve me qira	Pajisje të tjera	Mobilje zyrash dhe pajisje	Totali
Kosto							
Më 1 janar 2014	246,434,327	47,485,025	44,592,633	12,975,495	2,482,877	8,560,406	362,530,763
Shtesa	32,729,755	7,489,387	470,704	93,600	1,941,451	630,144	43,355,041
Nxjerrje nga përdorimi	(642,174)	-	-	-	-	-	(642,174)
Më 31 dhjetor 2014	278,521,908	54,974,412	45,063,337	13,069,095	4,424,328	9,190,550	405,243,630
Shtesa	2,353,175	374,698	-	-	1,307,500	-	4,035,373
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	(1,354,112)	-	(130,000)	-	(1,484,112)
Më 31 dhjetor 2015	280,875,083	55,349,110	43,709,225	13,069,095	5,601,828	9,190,550	407,794,891
Amortizimi i akumuluar							
Më 1 janar 2014	(15,791,331)	(8,701,394)	(7,507,915)	(2,135,801)	(324,101)	(914,575)	(35,375,117)
Shpenzimi per vitin	(24,694,860)	(9,764,075)	(8,956,013)	(2,603,827)	(531,848)	(1,700,894)	(48,251,517)
Nxjerrje nga përdorimi	29,282	-	-	-	-	-	29,282
Më 31 dhjetor 2014	(40,456,909)	(18,465,469)	(16,463,928)	(4,739,628)	(855,949)	(2,615,469)	(83,597,352)
Shpenzimi per vitin	(29,521,049)	(12,127,540)	(8,830,361)	(2,614,747)	(1,115,037)	(1,811,602)	(56,020,336)
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	624,069	-	13,000	-	637,069
Më 31 dhjetor 2015	(69,977,958)	(30,593,009)	(24,670,220)	(7,354,375)	(1,957,986)	(4,427,071)	(138,980,619)
Vlera kontabël neto							
Më 1 janar 2014	230,642,996	38,783,631	37,084,718	10,839,694	2,158,776	7,645,831	327,155,646
Më 31 dhjetor 2014	238,064,999	36,508,943	28,599,409	8,329,467	3,568,379	6,575,081	321,646,278
Më 31 dhjetor 2015	210,897,125	24,756,101	19,039,005	5,714,720	3,643,842	4,763,479	268,814,272

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***7. Aktive afatgjata jo-materiale**

	Programe TI	Licensa	Totali
Më 1 janar 2014	28,812,069	500,000,000	528,812,069
Shtesa	1,776,807	-	1,776,807
Më 31 dhjetor 2014	30,588,876	500,000,000	530,588,876
Shtesa	193,812	-	193,812
Më 31 dhjetor 2015	30,782,688	500,000,000	530,782,688
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 janar 2014	(6,013,418)	(33,333,333)	(39,346,751)
Shpenzimi per vitin	(6,371,738)	(50,000,000)	(56,371,738)
Më 31 dhjetor 2014	(12,385,156)	(83,333,333)	(95,718,489)
Shpenzimi per vitin	(6,531,083)	(50,000,000)	(56,531,083)
Më 31 dhjetor 2015	(18,916,239)	(133,333,333)	(152,249,572)
Vlera kontabël neto			
Më 1 janar 2014	22,798,651	466,666,667	489,465,318
Më 31 dhjetor 2014	18,203,720	416,666,667	434,870,387
Më 31 dhjetor 2015	11,866,449	366,666,667	378,533,116

8. Parapagimet

Më 31 dhjetor 2015, Shoqëria nuk ka parapagime (2014: 1,554,000 Lek). Parapagimet kryhen ndaj furnitorëve vendas për blerjen e pajisjeve.

9. Inventarët

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Biletat gërvishtëse	57,576,901	46,134,743
Pjese këmbimi	5,454,313	5,877,543
Skedat e lotarisë	5,316,440	5,713,443
Letër për bileta lotarie	1,743,194	2,345,890
Materialet e tjera	4,069,664	2,032,112
Totali	74,160,512	62,103,731

10. Kërkesa të arkëtueshme

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Kërkesa të arkëtueshme	31,343,906	19,422,481
Totali	31,343,906	19,422,481

Kërkesat e arkëtueshme përfaqësojnë një borxh afatshkurtër të pambledhur nga partneret kontraktuale më 31 dhjetor 2015 për shitjen e produkteve të lotarisë. Shuma e pashlyer paraqitet neto nga çmimet e paguara dhe komisionet bonus.

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

11. Aktive te tjera

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Shpenzime të shtyra	2,221,635	5,548,841
Shpenzime të parapaguara qiraje	2,657,593	3,452,538
Aktive të tjera	2,097,262	2,817,286
Totali	6,976,490	11,818,665

Shpenzimet e parapaguara të qirasë përfaqësojnë shuma të paguara palëve të treta si garanci për ambjentet e marra me qira nga Shoqëria për përdorim si zyra qendrore dhe apartamente për përdorim nga punonjësit.

Shpenzimet e shtyra përfaqësojnë parapagimet për primet e sigurimit të automjeteve, licensat e programit kompjuterik Oracle-it dhe shpenzime për shërbimet e internetit.

Aktive të tjera përfaqësojnë kolaterale për karta krediti dhe paradhënie ndaj punonjësve.

12. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<i>Mjete monetare në arkë</i>		
Ne Lek	2,108,425	1,372,378
Ne Euro	231,023	180,554
	2,339,448	1,552,932
<i>Llogari rrjedhëse</i>		
Ne Lek	6,457,756	10,118,844
Ne Euro	16,383,889	14,038,201
	22,841,645	24,157,045
<i>Depozita afat shkurtër</i>		
Ne Lek	672,719	2,333,500
Ne Euro	45,201	886,983
	717,920	3,220,483
TOTALI	25,899,013	28,930,460

13. Kapitali aksionar

Kontributi fillestar i kapitalit të Shoqërisë sipas rezolutës të Aksionerave e datës 21 shtator 2012 ishte 1,000,000 Lek.

Pas kontributit fillestar, pronaret e Shoqërisë derdhën kapital shtesë duke e rritur vlerën e kapitalit në 701,950,000 Lek sipas rezolutës së Aksionarëve që daton më 28 shtator 2012.

Një rritje tjetër e kapitalit prej 500,000,000 Lek u kontribua nga Aksionarët sipas rezolutës së Aksionarëve të datës 15 tetor 2012. Pas kësaj rritje, struktura e kapitalit me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është si vijon:

	Totali ne Lek	Në %
Albanisch Osterreichische Lotterien Holding Gesellschaft	1,201,950,000	100

14. Huatë

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<i>Raiffeisen Bank Sh.a.</i>		
Pjesa afatshkurtër e huasë	7,800	71,968,967
Pjesa afatgjatë e huasë	869,246,919	591,170,028
Totali	869,254,719	663,138,995

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***14. Huatë (vazhdim)**

Gjendja në 1 janar 2014	280,400,000
Disbursime gjatë vitit	420,288,225
Pagesa të principalit	(37,549,230)
Gjendja në 31 dhjetor 2014	663,138,995
Disbursime gjatë vitit	206,115,724
Pagesa të principalit	-
Gjendja në 31 dhjetor 2015	869,254,719

Më 13 maj 2013 Shoqëria nënshkroi një marrëveshje kredie me Raiffeisen Bank Albania për shumën totale prej 3 milion Euro e cila ka afat maturimi deri më 13 prill 2018. Huamarrja mbart një normë interesi prej 5% plus 1-vit Euribor, gjithsesi jo më pak se 5.9% në vit dhe kishte një periudhë faljeje deri në një vit. Huaja është siguruar nëpërmjet një garancie bankare emetuar nga Shoqëria mëmë.

Në mars 2014, Shoqëria ka nënshkruar një kontratë të dytë financimi me Raiffeisen Bank Albania, për një shumë prej 3 milionë Euro e cila maturohet më 28 shkurt 2019. Borxhi i dytë është marrë përkundrejt të njëjtave kushte si borxhi i parë, përveç periudhës së faljes.

Në gusht 2015, Shoqëria u rrefinancua duke mbyllur dhe huatë e mëparshme nëpërmjet një marrëveshje të re me Raiffeisen Bank Albania, për një shumë totale prej 7.5 milionë Euro që maturohet më 31 dhjetor 2020. Si rezultat, Shoqëria përfitoi një disbursim shtesë prej 1.6 milionë Euro gjatë vitit 2015. Huaja kishte një normë interesi prej 5% plus 1-vit Euribor, por jo më pak se 5.3% në vit dhe është e pagueshme në një kësht të vetëm në fund të periudhës së maturimit.

15. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Te pagueshmet ndaj furnitorëve me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Furnitorët vendas	10,795,492	42,465,534
Furnitorët e huaj	305,854	4,040,280
Palë të lidhura	104,227	1,027,033
Totali	11,205,573	47,532,847

16. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Detyrime të lojrave të fatit	48,019,189	60,984,962
Taksa të pagueshme	35,924,744	42,338,530
Shpenzime të përlllogaritura	4,663,495	11,443,143
Detyrime për sigurimet shoqërore	983,283	1,581,179
Të ardhura të shtyra	27,100	1,466,200
Provizione të tjera afatshkurtra	544,544	200,545
Detyrime ndaj personelit	2,870	27,294
Detyrime të tjera	1,946,935	1,450,019
Totali	92,112,160	119,491,872

Detyrimet e lojrave të fatit përfaqësojnë detyrime për çmimet fituese të “Lotos 6 nga 39” dhe të biletave gërvishtëse, të Keno dhe të FitoFito.

Tatimet e pagueshme përbëhen kryesisht nga tatimet për lojërat e fatit, tatimi mbi të ardhurat personale, TVSH e pagueshme si dhe tatimi në burim.

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***16. Detyrime të tjera (vazhdim)**

Gjatë 2014, Shoqëria ka qenë subjekt i një kontrolli tatimor nga Autoritetet Tatimore Shqiptare që ka patur si subjekt vitet financiare 2012 dhe 2013. Raporti final i kontrollit tatimor është lëshuar më 12 shkurt 2014, dhe detyrimet tatimore duke përfshirë gjokat tatimore si rezultat i këtij kontrolli arrijnë në vlerën 61,307,584 Lek. Ky vendim është apeluar nga Shoqëria në shkallën e parë të apelit në Drejtorinë e Apelimit Tatimor dhe detyrimi prej 28,860,000 Lek lidhur me TVSH është hequr.

Shoqëria ka paguar shumën prej 15,480,147 Lek për detyrimet tatimore të ngarkuara dhe për gjokat e lidhura me to, dhe ka apeluar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, vendimi i së cilës ka dalë në favor të Shoqërisë duke hequr pjesën e mbetur të detyrimeve. Ky vendim është apeluar dhe çështja gjyqësore është ende në proces, ndërsa Shoqëria ka njohur detyrime në lidhje me të për 17,999,435 Lek lidhur me tatimin mbi fitimin dhe gjokat (2014: 17,999,435 Lek) Shuma është e përfshirë në taksa të pagueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014.

Shpenzimet e përllogaritura përfshijnë taksa dhe tarifa të bashkisë, komunikimin me celular, auditin, konsulencën dhe të tjera të përllogaritura të pësuara në 2015, për të cilat faturat janë marrë në 2016.

17. Të ardhura nga lotaritë

	2015	2014
Të ardhura – Loto 6 nga 39	61,402,800	230,123,700
Të ardhura – Biletat gërvishtëse	222,579,700	348,464,000
Të ardhura – Fito Fito	1,398,150	7,257,050
Të ardhura-Keno	35,028,955	-
Totali	320,409,605	585,844,750

18. Shpenzime marketingu

	2015	2014
Shpenzime për mediat	28,742,977	161,394,459
Shpenzime për reklama dhe promocione	4,989,044	30,334,681
Tarifa për agjentët	3,257,535	17,142,871
Kërkime për tregun	-	1,422,653
Sponsorizimet	329,208	371,356
Shpenzime të tjera marketingu	-	207,744
Totali	37,318,764	210,873,764

19. Shpenzime për çmimet e lotarisë

	2015	2014
Fondi i çmimeve për biletat gërvishtëse	123,425,808	187,229,600
Fondi i çmimeve për loton 6 nga 39	32,545,218	115,499,496
Fondi i çmimeve për Keno	25,585,406	-
Fondi i çmimeve për Fito – Fito	485,669	6,820,246
Totali	182,042,101	309,549,342

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

20. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit përbëhen nga sa më poshtë:

	2015	2014
Shpenzime page	85,675,627	111,312,953
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	7,887,440	10,827,613
Bonuse dhe shpërblime të tjera	44,900	9,958,673
Totali	93,607,967	132,099,239

21. Taksat dhe tarifat e lojrave

	2015	2014
Tatimi për lojrat e fatit	31,934,391	59,808,510
Tarifë kontributi për çështjet e mira	7,025,565	13,157,871
Tarifa administrimi ndaj 'Njesia mbikqyese e lojrave te fatit'	1,999,997	2,990,427
Totali	40,959,953	75,956,808

Bazuar në marrëveshjen e koncesionit, Shoqëria transferon kontributin prej 2.2% tek Ministria e Financës, si kontribut për çështje të mira.

22. Komisione ndaj agjentëve

Lotaria Kombëtare operon me shumë partnerë kontraktualë, të cilët tregtojnë produktet e Shoqërisë në gjithë territorin e Shqipërisë. Partnerët kontraktualë janë krijuar në mënyrë të pavarur nga Shoqëria, si subjekte të regjistruara ose persona fizike dhe përfitojnë nga komisionet e shitjeve në varësi të volumit të shitjeve. Për vitin 2015 dhe 2014 komisionet ndaj agjentëve janë si më poshte:

	2015	2014
Komisione ndaj agjentëve – Bileta gërvishtëse	25,039,190	30,462,572
Komisione ndaj agjentëve - Lotto	5,904,946	19,188,265
Komisione ndaj agjentëve - Keno	2,841,615	-
Komisione ndaj agjentëve - Fito Fito	99,508	1,252,281
Totali	33,885,259	50,903,118

23. Kosto e materialeve të përdorura

	2015	2014
Kosto e biletave gërvishtëse	10,431,715	14,148,526
Kosto e skedave të lotarisë	396,021	4,373,415
Kosto letrës së biletave të lotarisë	1,051,136	2,678,620
Totali	11,878,872	21,200,561

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***24. Shpenzimet e tjera operative**

Shpenzimet e tjera operative përbëhen nga sa më poshtë:

	2015	2014
Shpenzime qiraje	16,508,677	24,288,872
Shpenzime telekomunikimi dhe postare	7,916,789	14,151,952
Taksa te tjera nga tatim fitimi	5,860,254	19,876,720
Shpenzime TI	4,686,415	2,213,272
Shpenzime këshillimi	4,615,507	9,220,605
Mirëmbajtje dhe riparime	3,709,830	4,372,222
Materiale dhe furnizime	3,700,007	4,214,698
Shpenzime karburanti	3,183,231	4,714,103
Gjoha për tatime	3,033,462	35,487,433
Sigurime	1,871,544	2,050,740
Shpenzime sigurie	1,612,800	1,711,789
Shpenzime përfaqësimi	1,118,300	3,728,658
Shpenzime komunale	1,087,823	1,087,323
Tarifa për ofrimin e shërbimit Keno	1,050,488	-
Shpenzime udhëtimi	703,271	4,122,591
Humbja nga nxjerrja nga përdorimi e aktiveve fikse	657,706	282,243
Provizione për raste gjyqësore	344,000	-
Trajnime	147,649	553,524
Punësim i personelit	101,400	3,301,716
Shpenzime rekrutimi	-	494,400
Shpenzime të tjera	3,158,067	7,637,497
Totali	65,067,220	143,510,358

25. Të ardhura dhe shpenzime financiare, neto

	2015	2014
<i>Të ardhura financiare</i>		
Të ardhurat nga interesi mbi depozitat bankare	11,927	159,170
Fitimi neto nga diferencat e konvertimit	17,039,152	-
Të ardhura të tjera financiare	1,847	311,395
Total i të ardhurave financiare	17,052,926	470,565
<i>Shpenzimet financiare</i>		
Komisione bankare	(224,966)	(291,781)
Humbjet neto nga diferencat e konvertimit	-	(655,284)
Shpenzimet e interesit	(46,298,152)	(29,624,131)
Shpenzime të tjera financiare	(237,688)	(275,414)
Total i shpenzimeve financiare	(46,760,806)	(30,846,610)
Shpenzime neto financiare	(29,707,881)	(30,376,045)

Lotaria Kombëtare sh.p.k**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***26. Tatimi mbi fitimin**

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%). Norma tatimit mbi fitimin prej 15%, është efektive nga 1 Janari 2014, në zbatim të dispozitave të reja ligjore të tatimit mbi fitimin.

Tatimi i njohur në fitimin ose humbjen për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhet nga sa më poshtë:

	2015	2014
Shpenzimi i tatim-fitimit	-	-
Shpenzimi tatimor i shtyrë	(6,439,120)	(3,876,359)
Totali	(6,439,120)	(3,876,359)

Rakordimi i tatim fitimit efektiv	%	2015	%	2014
Humbja për vitin		(237,027,430)		(492,867,640)
Tatim fitimi me normën e aplikueshme	(15)	35,554,115	15	73,930,146
Shpenzimet e panjohura të përhershme	4	(9,857,447)	(2.2)	(11,069,848)
Humbjet e panjohura tatimore aktuale	13	(31,814,854)	(13.6)	(66,799,586)
Diferenca të përkohshme të panjohura më parë	0.14	(320,934)	(0.01)	62,929
Totali		(6,439,120)		(3,876,359)

Efekti për humbjet tatimore të mbartura (neto) që prej 2013 paraqiten si më poshtë:

	2013	2014	2015
Humbjet tatimore	52,940,307	66,799,586	31,814,854
Humbjet tatimore të mbartura	53,940,372	120,739,958	152,554,812

Sipas ligjit Shqiptar, çdo humbje tatimore mund të mbartet deri në tre vite pasardhëse të njëpasnjeshme. Më 31 dhjetor 2014 dhe 2013, nuk ka patur përdorim të humbjeve tatimore.

Tatim fitimi i shtyrë llogaritet bazuar në normën e miratuar tatimore 15% (2014: 15%). Aktivi dhe detyrim i tatimor i shtyrë i njohur u atribuohet zërave të mëposhtëm:

Të njohur	Aktivi		Detyrimi		Neto	
	2015	2014	2015	2014	2015	2014
Aktive afatgjata materiale	-	-	4,912,996	4,495,270	(4,912,996)	(4,495,270)
Shpenzime të nisjes	4,002,422	4,554,479	-	-	4,002,422	4,554,479
Aktive afatgjata jo-materiale	-	-	7,120,466	3,637,562	(7,120,466)	(3,637,562)
Detyrime të tjera	408,300	2,394,732	-	-	408,300	2,394,732
	4,410,722	6,949,211	12,033,462	8,132,832	(7,622,740)	(1,183,621)

Lotaria Kombëtare sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

27. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria ka qenë e përfshirë në disa pretendime ligjore dhe gjyqesore me konkurentë, punonjës dhe administratën shtetërore për të cilat provizionet e lidhura me to janë njohur sipas nevojës.

Angazhimet për qira operative

Shoqëria nuk ka asnjë marrëveshje qiraje operative të paanulueshme në 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014. Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje qiraje për ambientet e zyrave të veta dhe për apartamente të cilat janë të anulueshme me njoftim paraprak sipas kushteve kontraktuale. Kontratat e qirasë operative janë të anulueshme, me një periudhë maksimale njoftimi prej 90 ditësh. Angazhimet maksimale të paanulueshme të qirasë më 31 dhjetor 2015 janë 2,985 mijë Lek (2014: 3,527 mijë Lek).

Garanci te vëna për Shoqërinë

Österreichische Lotterien Gesellschaft m.b.H. (shënimi 1) ka dhënë një garanci në shumën e 20,000,000 Lek, ndaj Ministrisë së Financave, Qeveria Shqiptare, siç kërkohet nga kushtet e marrëveshjes së licencës.

28. Palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura që përfaqësojnë transaksione me Shoqërinë mëmë, Österreichische Lotterien Gesellschaft m.b.H. (shënimi 1), dhe manaxhimin kryesor, janë detajuar më poshtë:

	2015	2014
<i>Të ardhura</i>		
Shërbime midis kompanive	38,421,825	-
<i>Shpenzime</i>		
Shpërblime ndaj menaxhimit	-	18,637,559
Garanci bankare	237,142	274,594
<i>Të pagueshme</i>		
Oesterreichische Lotterien GmbH	103,836	1,027,033
<i>Te arkëtueshme</i>		
Oesterreichische Lotterien GmbH	4,163,948	367,471

Totali i kompensimit të paguar për drejtuesit kryesorë të Shoqërisë gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015 është 23,883,839 Lek (2014: 18,637,559 Lek). Një pjesë e këtyre kostove i janë alokuar dhe ngarkuar Mëmës gjatë vitit.

Garancitë e vëna nga palë të lidhura janë përmëndur në shënimet 27 dhe 14.

29. Ngjarjet pas datës së raportimit

Sipas marrëveshjes së blerjes së aksioneve, më datë 3 maj 2016 midis Österreichische Lotterien Gesellschaft m.b.H (“shitësi”) dhe Novomatic Gaming Industries GmbH (“blerësi”), palët bien dakord për të transferuar kontrollin indirekt të Shoqërisë, gjë që do të konsiderohet e përfunduar vetëm pas përmbushjes së kushteve të mbylljes siç përcaktohen në marrëveshjen e nënshkruar, të cilat lidhen me miratimet e kërkuara nga autoritetet përkatëse shtetërore në Shqipëri, si një parakusht për transferimin e pronësisë.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit për të cilat kërkohet rregullim apo shënim në këto pasqyra financiare.